



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	07.08.2025
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Korrik

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.07.2025 deri me 31.07.2025

Lipjan 2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit Korrik, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Lipjanit ka zhvilluar një sërë aktivitete të rëndësishme me fokus në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe përmirësimin e kushteve të punës për fermerët tanë.

Në fillim të muajit, është mbajtur një takim me Ministrin e Bujqësisë, ku është diskutuar dhe rekomanduar çmimi për shërbimin e korrje-shirjeve të grunajave. Si rezultat, është përcaktuar çmimi prej 130 € për hektar, si një formë rekomandimi për të gjithë kumbangjinjtë.

Pas këtij vendimi, Drejtoria ka hartuar dhe shpërndarë vendimin për çmimin e korrje-shirjes, i cili u është dërguar të gjitha kompanive (kumbajnave) që ofrojnë këtë shërbim, me qëllim të unifikimit të çmimeve dhe lehtësimit të punës për fermerët.

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm ka qenë monitorimi nga afër i procesit të korrje-shirjeve në terren. Komisioni i formuar për këtë sezon ka dalë në terren për të përcjellë nga afër mbarëvajtjen e korrjeve. Sipas të dhënave zyrtare, këtë vit në territorin e Komunës së Lipjanit janë kultivuar gjithsej 5,878.11 hektarë me grurë, ndërsa rendimenti mesatar për hektar ka arritur në rreth 6000 kg.

Fatkeqësisht, gjatë muajit Korrik janë raportuar edhe disa raste të zjarreve në fusha, kryesisht në zona të theksuara bujqësore, si në fshatin Krojmir, ku janë djegur mbi 20 hektarë me grurë. Komisioni komunal ka dalë menjëherë në terren për të evidentuar dëmet dhe për të bërë vlerësimin e saktë të sipërfaqeve të prekura. Synimi është që të ndërmerren masa konkrete për të ndihmuar fermerët e dëmtuar.

Po ashtu, gjatë këtij muaji, është bërë shpërndarja e 87 motokultivatorëve për përfituesit nga lista e pritjes. Përfituesit janë uruar dhe njëkohësisht është rikonfirmuar përkushtimi ynë për t'i mbështetur në mënyrë të vazhdueshme me projekte konkrete dhe mbështetje teknike.

Gjithashtu, gjatë muajit Korrik, në bashkëpunim me organizatën IADK dhe partnerin ndërkombëtar FRIEDA nga Zvicra, kemi organizuar ceremoninë e shpërndarjes së certifikatave dhe granteve për gratë nga Komuna e Lipjanit, të cilat me sukses kanë ndjekur dhe përfunduar trajnimin profesional në fushën e pasticerisë.

Ky aktivitet shënon një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit ekonomik të grave dhe nxitjes së ndërmarrësisë lokale në sektorin e prodhimit ushqimor.

Ndër aktivitetet e rëndësishme të muajit korrik është edhe bashkëpunimi me një organizatë ndërkombëtare nga Katari. Në një takim të përbashkët me përfaqësuesit e organizatës dhe kryetarin e Komunës, është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit për realizimin e dy projekteve në sektorin e bujqësisë: furnizimi me motokultivatorë dhe ndërtimi i serrave me sipërfaqe 1 ari për fermerët përfitues.